



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Doretuar Punijeno / Prodato Received / Delivery | 29.12.2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPMSHICK | 8607/2022 | | 1/4 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1039/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1039/2022 me datë 22.11.2022 përmes postes së Kosovës me datë 18.11.2022 me numër R 2626920, e parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.1039/2022 e datës 20.11.2022 e parashtruar nga ankuesit
- II. *Anulohet* Vendimi me numër protokolli 041 i datës 26.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. *Obligohet* Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në vendin e punës “*Zyrtar korrektuese*”, në Qendrën Paraburgimit në Prizren, sipas kontratës së punës të datës 02.07.2018, ndaj të cilit është iniciuar procedurë disiplinore me kërkesën e datës 30.09.2022 nga Koordinatorin e Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve /Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, në bazë të Njoftimit (E-mailit) të datës 02.09.2022 të në pozitë të i cili ka deklaruar se ankuesi në zyrën e tij ka bërë sjellje të pa hijshme, duke rënë ndesh me nenin 46 paragrafi 4.3

dhe neni 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, si dhe me nenin 2 nën paragrafi 1.9, neni 5 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MD- Nr.01/2016 të Kodit të Etikës Profesionale për Zyrtarët Korrektues, në Shërbimin Korrektues.

Komisioni Disiplinorë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 26.10.2022 ka nxjerrë Vendimin KD.nr.041/2022, me të cilin ankuesit i është shqiptuar masë e rëndë disiplinore "20% ndalim nga paga për periudhën një (1) mujore".

Ankuesi kundër Vendimit KD.nr.041/2022 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinorë, ka parashtruar ankesë me datë 22.11.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, përmes postes së Kosovës me datë 11.11.2022 me numër R 2626920, i cili pretendon se masa e rëndë disiplinore i është shqiptuar në kundërshtim me ligjin në fuqi, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore është bërë vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 01.12.2022 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Me datë 13.12.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, përmes e-mailit zyrtar, i protokolluar me numër 7997/2022.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesë e datë 22.11.2022 me numër protokoll 7310/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postes së Kosovës me datë 11.11.2022 me numër R 2626920 (pliko); Vendim KD.nr.041/2022 i datës 26.10.2022 i Komisionit Disiplinorë në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datë 12.12.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, përmes e-mailit zyrtar, i protokolluar me numër 7997/2022 me shkresën zyrtare e datës 09.12.2022 me nr. 1304; Kontratë e punës, për ankuesin e datës 02.07.2018, me përshkrim të detyrave të punës të datës 03.01.2020; Shkresë për marrjen e të burgosurit me transport-automjetin zyrtar i datës 29.08.2022; Urdhëresë Pnr.2008/2022 e datës 22.08.2022; Kërkesë për procedurë disiplinore e datës 30.09.2022; E-mail i datës 02.09.2022, e datës 01.09.2022; Procesverbali i datës 06.10.2022 prej 1/3 faqe; Vendim i datës 13.10.2022 me nr.1039; Vendim i datës 11.02.2022 me nr.0139.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, vlerësoi që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale gjegjësisht sipas kontratave të punës për kohë të pacaktuar, është konstatuar se ankuesi është i punësuar në Qendrën e Paraburgimit në Prizren sipas kontratës së punës të datës 02.07.2018 në pozitën e punës *Zyrtar Korrektues*.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 30.09.2022, Udhëheqësi i Njësitit për Përcjelljen e të Burgosurve ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, për shkak të supozimit se : *i njëjtit me datë 30.08.2022, ka qenë i obliguar të zbatojë Urdhëresën me numër 7586/2022 të datës 30.08.2022 për përcjelljen e të burgosurit nga QP Prishtinës për në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në përcjelljen e këtij të burgosuri kanë qenë të angazhuar dhe tre zyrtarët korrektues, nga Njësia e NJPB-së QP në Prizren. Të njëjtit pas përfundimit të seancës gjyqësore kanë vazhduar për në Drejtorinë Qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pa e njoftuar udhëheqësin e tij dhe pa aprovimin e tij. Si dhe duke u bazuar në deklaratën e zëvendësuesit të Drejtorit të personelit të SHKK-së ankuesi/oficeri ka bërë shkelje të rregullave të punës duke u sjellë në mënyrë jo etike dhe arrogante ndaj dhe për shkak të mos kthimit të ankuesit në vendin e punës respektivisht në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, pas përfundimit të seancës gjyqësore dhe dorëzimit të të burgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, ka*

kërkuar nga komisioni disiplinor që të veprojë në bazë të kompetencës shqyrtimin e këtij rasti dhe të vendos për përgjegjësin disiplinore lidhur me shkeljet e gjetura dhe me dyshimin se ankuesi sipas deklaratës së ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës dhe shkelje të etikes profesionale.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues i Kosovës më Vendimin me numër protokolli 041 të datë 26.10.2022 ka shpalluar ankuesin përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.10 dhe nenit 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "ndalimi i 20% e pagës për periudhën një (1) muaj", duke shtuar se masa disiplinore bazohet në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 041 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se vendimi i kundërshtuar nuk ka vërtetuar gjendjen faktike duke bërë vërtetim të gabuar dhe pretendon se nuk ka qenë vozitës i automjetit dhe nuk ka qenë përgjegjës për shkuarjen në Drejtorin Qendror të Shërbimit Korrektues, kurse ata që kanë qenë përgjegjës nuk janë sanksionuar, dhe sa i përket sjelljes jo etike në të cilën është bazuar vendimi i nxjerrë, pretendon se nuk kam pasur asnjë shkelje të rregullave disiplinore me rastin e shkuarjes në Drejtorin Qendror, sepse arsyeja e shkuarjes ka qenë për të shikuar vlerësimin e testit me shkrim dhe komunikimi me _____ ka qenë korrekt ku prezent kanë qenë _____

Po ashtu ai pretendon se përbërja e anëtareve të komisionit disiplinor në seancën dëgjimore ka qenë e ndryshme gjegjësisht kane qenë personat e ndryshëm në seance dëgjimore dhe në vendimmarrje, andaj i propozon Këshillit që ti aprovoj si të bazuar ankesën dhe të anuloj Vendimin me numër protokolli 041/2022 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinor, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore " ndalim 20 % i pagës për periudhën prej një muaji".

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit referuar përbërjes së Komisionit Disiplinor, ka analizuar provat e lëndës dhe rrjedhimisht ka gjetur së me Vendimin me numër protokolli 0139 të datës 10.02.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është themeluar Komisioni Disiplinor me mandat tre (3) vjeçar në përbërje nga _____ kryesues, _____ anëtar dhe _____ anëtare, kurse më Vendimin me numër protokolli 139 të datës 13.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është shfuqizuar Vendimi me numër protokolli 0139 i datës 10.02.2022, dhe është themeluar Komisioni Disiplinor më përbërje nga:

_____ në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë-Kryesues, _____ -Zyrtare e Burimeve Njerëzore-anëtare dhe

_____ -Zyrtar Ligjor në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë-anëtar, me arsyetimin se ndryshimi i përbërjes së Komisionit behët për shkak së njëri nga anëtarët e komisionit i cili ka qenë në nivel profesionale ka kaluar në pozitë të nivelit drejtues. Me tej Kolegji nga vlerësimi i provave të lëndës konstaton së në kohën e inicimit të procedurës disiplinor me datë 30.09.2022 ka qenë në fuqi Vendimi me numër protokolli 0139 i datës 10.02.2022 mbi themelimin e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa sipas nënshkrimeve në procesverbalin e seancës së datës 06.10.2022, Kolegji vërteton se i njëjti është nënshkruar nga _____

dhe _____ pra _____ ka marrë pjesë në seancë dëgjimore në cilësi të kryesuesit të Komisionit Disiplinor pa lëshim të Vendimit me numër protokolli 1039 të datë 13.10.2022, ndërsa vendimi i kundërshtuar me ankesë është nënshkruar nga _____ në _____



cilësi të kryesuesit,
Disiplinor.

dhe

-në cilësi të anëtareve të Komisionit

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit, trajtimi i përgjegjësishë disiplinore të ankuesit nga Komisioni me përbërje të ndryshme të anëtareve është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin përcaktohet se : 1. *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.* 2. *Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj...* kështu që nisur nga rrethanat si më sipër, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një akt administrativ i nxjerr në mungesë të autorizimit nga një ligj dhe nga organi jo kompetent është akt i paligjshëm.

Andaj, sa me sipër dhe duke qenë se Vendimi me numër protokolli 041 i datës 26.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritorie lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe rrjedhimisht vlerësoi që kjo çështje ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, i cili ka qenë i emëruar në kohën e inicimit të procedurës disiplinore, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen në fjalë dhe të nxjerr vendim në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë.

Bazuar në këto rrethana si me lart, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1039/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së .